




TRANSPAROMETRI KOMUNAL

PRIZREN, SUHAREKË, RAHOVEC,
MALISHEVË, DRAGASH, MAMUSHË

JANAR - QERSHOR 2015

KORRIK 2015, PRIZREN.





INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS



QEVERISJA LOKALE
DHE PJESEMARRJA
QYTETARE



TRANSPAROMETRI KOMUNAL

PRIZREN, SUHAREKË, RAHOVEC,
MALISHEVË, DRAGASH, MAMUSHË

JANAR - QERSHOR 2015

COPYRIGHT © 2015. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij reporti është bërë i mundur me përkrahjen e The Olof Palme Center. Opinionet, të gjeturat dhe rekondimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

PËRMBAJTJA

METODOLOGJIA	8
RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE	8
PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE	9
RENDITJA E KOMUNAVE	9
TRANSPARENCA NË MALISHEVË	12
Transparenca në Rahovec	14
Transparenca në Prizren	16
Transparenca në Suharekë	18
Transparenca në Dragash	20
Transparenca në Mamushë	22
REKOMANDIMET	26
Reformimi i Menaxhimit të Ueb-faqeve	26
Dokumente Lehtë të Qasshme Online	26
Transparencë Buxhetore për Pjesëmarrje Qytetare	27
Ri-Organizim Institucional për Avancim të Transparencës	27
Komuna e Malishevës	27
Komuna e Prizrenit	28
Komuna e Rahovcit	29
Komuna e Suharekës	29
Komuna e Dragashit	30
Komuna e Mamushës	30
ANEKSET, INDIKATORËT DIIJE KOMETET	32

(D)

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

HYRIE

Transparencia dhe hapja e një institucioni ndaj publikut është tregues thelbësor për mënyrën e qeverisjes së atij institucioni nga udhëheqësit, të zgjedhurit. Në një sistem të shëndoshë demokratik, secili institucion publik qoftë lokal apo qendror duhet të jetë transparent dhe i hapur, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të kenë mundësi të marrin pjesë aktive në proceset e vendimmarres. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, një institucion konsiderohet i hapur, kur para së gjithash qytetarëve u mundësohet që të jenë të pranishëm, madje edhe fizikisht dhe të përciellin nga afër punimet e tij.

Rëndësia e transparencës shtohet edhe më tutje kur kemi të bëjmë me institucionet lokale. Ato si të tilla janë mekanizmi i parë ku qytetari adreson problemet dhe shqetësimet e tij dhe komunitetit. Rruga, trotuaret, uji, kanalizimet, shkollat, mirëgenia janë problemet jo vetëm që duan zgjidhje nga autoritetet lokale, por edhe alternativat për zgjidhje duhet të nxjerrjen pas një procesi transparent dhe pas një konsultimi të gjerë me qytetarët e asaj komune.

Nëse ndodh e kundërta, kjo mund të qoj në keqpërdorime të pushtetit, niveli i ulët i këtij elementi thelbësor të qeverisjes, transparencës ndaj publikut, shkakton mos informim të duhur të publikut, ngrit mosinteresimin e publikut në punët publike dhe ulë pjesëmarrjen qytetare, një tjetër element i rëndësishëm për qeverisje të mirë.

Në kontekstin e bazës ligjore për transparencë në Komuna, vendi ynë ka një kornizë solide e cila garanton institucione transparente në funksion të qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisjen lokale, ligji për qasjen në dokumente publike janë dokumentet themelore që përcaktojnë transparencën e institucioneve lokale. Normalisht me jo më pak rëndësi janë edhe aktet dhe konventat ndërkombëtare si Karta e Evropiane e për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat Kosova edhe pse ende nuk është palej nënshkruese i ka pranuar si akte të zbatueshme në legjislacionin vendor.

Përkundër ekzistencës së bazës ligjore me gjithatë shumë raporte ndërkombe të, me theks të veçantë Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, në vazhdimësi ka adresuar kritika në kontekstin e kufizimeve në transparencën e institucioneve lokale. Raporti i këtij institucioni për vitin 2014 duke ju referuar komunave të Kosovës ndër të tjera thuhej se: "Përprojekjet komunale për të rritur transparencën në vendimarrje duhet të vazhdojnë. Një Udhëzimi i ri Administrativ për transparencën në komuna është zbatuar në vetëm dy komuna"¹.

Me qëllim të përmirësimit të këtij procesi KDI ka filluar monitorimin e 6 Komunave të Regionit të Prizrenit, me theks të veçantë transparencën e tyre karshi publikut. Kjo matje realizohet përmes një indeksi i cili ngërthen në vete 44 indikatorë matës të transparencës komunale. Përmes këtyre indikatorëve provohet të sillet një metodologjia lehtë dhe objektive për matje të transparencës në komuna dhe gatishmérinë e zyrtarëve lokal për të qenë të hapur ndaj publikut dhe gjithëpërfshirës në vendimmarje. Pra, Transparometri përbën në vete një mekanizëm të krahasimit të transparencës së qeverive lokale të udhëhequra nga subjekte të ndryshme politike. Po ashtu, ky indeks krijon mundësinë që të dallohen komunat me performance më të mirë nga ato me performance më të dobët në qeverisje dhe të mënjanojë përgjithësimet në vlerësim të komunave që shpesh janë abuzuar nga akterë të ndryshëm.

¹Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2014, f.9. Gjendet në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

METODOLOGJIA

Vlerësimi i Transparometrit ndjek një metodologji të matjes së indikatorëve në mënyrë objektive përgjatë katër shtyllave themelore të qeverisjes lokale. Ky indeks përbëhet nga 44 indikatorë dhe matë transparencën në *Zyrën e Kryetarit/es, Kuvendin e Komunës, Financat Komunale* dhe transparencën në *Konsultime me Publikun* (secila nga katër shtyllat përmban nga 11 indikatorë).

Indikatorët janë përzgjedhur me kujdes duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat nën qeverisjen lokale që përcaktohen me ligjet në fuqi. Indikatorët prekin përgjegjësitë bazike të qeverive lokale, aty ku transparenca duhet të jetë e garantuar, dhe nuk shkon në thellësi të matë transparencën edhe në disa sektorë specifik që janë nën kompetencën e komunës si transparenca në shëndetësi, arsim apo planifikim urban.

Para se të fillojë vlerësimi i transparencës komunale me indikatorë, KDI ka ndarë dhe diskutuar në fokus grup me zyrtarët për informim të komunave nën vlerësim (përfaqësuesit e dy nga komunave s'kanë qenë prezentë edhe pse të ftuar).

RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE

Rëndësia dhe pesha e indikatorëve është përcaktuar varësisht nga ndikimi që mund të ketë në kontekstin e transparencës së institucioneve komunale.

Kjo rëndësi e indikatorëve është shprehur në numra dhe varion nga 1 deri në 3 (shikoni *Aneksin I* për indikatorët dhe peshën e tyre). Për secilën nga katër shtyllat, pesha maksimale e 11 indikatorëve së bashku është 35.

Ndërsa vlerësimi i secilit indikatorë është bërë me notën 0 deri në 3 (0 është dhënë aty ku komuna s'ka qenë fare transparente, 3 është dhënë në ata indikatorë ku komunat kanë qenë plotësisht transparente, ndërsa 1 dhe 2 janë dhënë për ata indikatorë ku komuna ka qenë pjesërisht transparente). Nota vlerësuese (0-3) është përpjesëtuar me peshën indikatorit dhe është nxjerrë një vlerësimi i atij indikatorit. Shuma e notave vlerësuese të 11 indikatorëve ka dhënë dhe notën e përgjithshme për komunën në atë shtyllë (*Zyre të Kryetarit/es, Kuvend Komunal etj*).

Matja e transparencës së indikatorëve është bërë përmes katër mënyrave: ueb-faqes zyrtare të komunës, intervistimit të zyrtarëve komunal (pozitë dhe opozitë), monitorimit të takimeve zyrtare të komunave dhe kërkesave për qasje në dokumente publike.

PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të programit të qeverisjes lokale implementon projektin “Pjesëmarrja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie” projekt ky i cili mbështet nga Olof Palme International Center (OPIC). Projekti i tillë ka për synim monitorimin dhe vlerësimin e Kuvendeve të Komunave të rajonit të Prizrenit me qëllim të ndikimit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënis nga institucionet vetëqeverisëse lokale.

Një nga qëllimet e Transparometrit është edhe nxitja e konkurrencës për performancë më të mirë në transparencë. Andaj, në vlerësimin e indeksit që do të shpaloset më poshtë janë të përfshira gjashtë (6) komunat e regionit të Prizrenit (Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash dhe Mamushë).

RENDITJA E KOMUNAVE

Në përgjithësi transparenca në komuna (këto të përfshira në studim) ka lënë për tu dëshiruar, duke përfshirë këtu disa nga komunat me kryetarë të rinj. Nga 44 indikatorët matës që përbëjnë këtë indeks, kryesisht në katër fusha thelbësore të qeverisjes lokale, asnjë komunë nuk del të jetë 100% transparente. Kjo tregon që edhe komunat me performancën më të mirë në qeverisje kanë ndëpunë për të bërë që të jenë plotësisht transparente, së paku në këto çështje thelbësore të qeverisjes që ky indeks i adreson.

Disa pengesa tek transparencia komunale shkaktohen nga Ministria për Administratë Publike për shkak se ajo është përgjegjëse për platformën dhe menaxhimin e ueb-faqeve të komunave, gjë që kufizon komunat në përpjekje për të bërë dokumente dhe informata lehta të qasshme për qytetarët e saj. Ueb-faqet e komunave janë të centralizuara dhe nuk lejojnë hapësirë për modernizim dhe përshtatje të ueb-faqeve për qytetarët nga komunat e tyre përkatëse. Duke pasur parasysh përdorimin e internetit në kohët e sotme, ueb-faqet janë tejet të rëndësishme për institucionet publike të bëjnë informatat dhe dokumentet lehta të qasshme për publikun.

Përgjegjësia më e madhe për hapje të komunës ndaj qytetarëve i mbetet udhëheqësve lokal dhe administratës lokale. Shpërndarja e informatës për planet, planifikimet buxhetore dhe planifikimet e projekteve mbeten sfida që duhet të adresohen dhe praktikohen nga vetë udhëheqësit komunal. Gjatë punës tone, shumë herë kemi has në mos gatishmëri për të ndarë informatën, herë për shkak të mos vullnetit, herë për shkak të frikës se zyrtarëve të administratës për të ndarë një informatë publike pa dijen e udhëheqësve politik të komunave.

MAPL gjithashtu mund të bëjë shumë më shumë që rregulloret që i lëshon të zbatohen në nivel komunal. Kjo ministri shpesht anashkalon mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve për komuna. Kurse Asociacion i Komunave mund të bëjmë më shumë në koordinimin e komunave që të adresojnë sfidat me të cilat komunat përballen për të qenë më të hapur ndaj publikut dhe më të qasshëm nga publiku dhe si të ngriten kapacitetet për të qenë më transparent.

Nga 44 indikatorët matës të transparencës që përbëjnë këtë Transparometër (shih metodologjinë për përzgjedhje e indikatorëve dhe *Aneksin 1* për indikatorët dhe peshën e tyre në vlerësim) del se disa ngecje në qeverisje komunat i kanë të përbashkëta dhe kurse disa ngecje që qëndrojnë tek një komunë nuk qëndrojnë tek disa të tjera. Të gjeturat e këtij indeksi tregojnë që performance në transparencë e komunave dallon dhe përderisa disa komuna janë në rrugë të mirë për të arritur transparencë totale në

TRANSPAROMETRI KOMUNAL


(D) (D)

çështje bazike, disa komuna janë hermetikisht të mbyllura ndaj publikut.

SHTYLLA	PIKË TË MUNDSHME	VLERËSIMI PËR KOMUNË					
		Prizren	Suharekë	Rahovec	Malishevë	Dragash	Mamushë
Ekzekutivi	35.0	20.0	15.7	14.3	14.0	6.7	4.0
Kuvend	35.0	19.0	18.0	21.7	19.3	13.7	13.0
Financa	35.0	5.0	5.0	17.0	9.3	3.0	6.0
Konsultime me publikun	35.0	11.0	9.0	4.0	16.3	4.3	4.7
Pikë/Komunë	140	55.0	47.7	57.0	58.9	29.4	27.7
Mesatarja e Pikëve	18.2	13.8	11.9	14.3	14.7	6.9	6.9
Nivel i Transparencës		39.3 %	34.1 %	40.7 %	42.1 %	19.8 %	19.8 %

Në bazë të gjeturave të këtij indeksi me 44 indikatorë në katër fushat bazike të qeverisjes lokale, të matur për periudhën gjashtë mujore (janar-qershori 2015) del se Komuna e Malishevës ka qenë komuna me transparente nga gjashtë komunat e matura me 42.1 % transparente. Pastaj radhitën Komuna e Rahovecit (40.7 % transparente), Komuna e Prizrenit (39.3 % transparente), Komuna e Suharekës (34.1 % transparente), Komuna e Dragashit dhe Komuna e Mamushës me nga (19.8% transparente).

NIVELI I TRANSPARENCËS KOMUNALE



Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në *Transparometrin e Zyrës së Kryetarit/ës*, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Prizrenit (20 pikë), Komuna e Suharekës (15.7 pikë), Komuna e Rahovecit (14.3 pikë), Komuna e Malishevës (14.0 pikë), Komuna e Dragashit (6.7 pikë) dhe Komuna e Mamushës (4 pikë).

Radhitja e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Kuvendit të Komunës*,

(D) (D)

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMMARRJA QYTETARE

nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Rahovecit (21.7 pikë), Komuna e Malishevës (me 19.3 pikë), Komuna e Prizrenit (me 19 pikë), Komuna e Suharekës (18.0 pikë), Komuna e Dragashit (13.7 pikë) dhe më paku transparente në kuvend komunal del të jetë Komuna e Mamushës (13.0 pikë).

Radhitja e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Financave Komunale*, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Rahovecit (17.0 pikë), Komuna e Malishevës (9.3 pikë), Komuna e Mamushës (6.0 pikë), Komuna e Prizrenit dhe Suharekës me nga (5.0 pikë), dhe Komuna e Dragashit (3.0 pikë).

Radhitja e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Konsultimeve me Publikun*, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna Malishevës (me 16.3 pikë), Komuna e Prizrenit (me 11.0 pikë), Komuna e Suharekës (9.0 pikë), Komuna e Mamushës (4.7 pikë), Komuna e Dragashit (4.3 pikë) dhe Komuna e Rahovecit (me 4.0 pikë).


TRANSPARENCA NË KOMUNË

TRANSPARENCA NË MALISHEVË

Komuna e Malishevës del të jetë komuna e parë më transparente me një nivel të transparencës prej 42.1 %. Institucioni më transparent i Komunës së Malishevës është Kuvendi Komunal në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 19.3 pikë, ndërsa Kuvendi Komunal i Malishevës është më pak transparentë në fushën e financave ku është vlerësuar me 9.3 pikë. Komuna e Malishevës nuk ka të publikuar asnjë raport të punës së Kryetarit për gjashtë muaj dhe Kryetari i Komunës gjatë periudhës janar-qershor nuk ka reportuar në Kuvend për punën e tij si dhe nuk ka asnjë raport për konsultime me publikun dhe kësisoj transparenca e ekzekutivit komunal është vlerësuar me 14.0 pikë nga 35 pikë të mundshme nga 11 indikatorët në shtyllën e transparencës së ekzekutivit komunal.

TRANSPARENCA NË MALISHEVË (NISMA)

MALISHEVË



“Transparenca e Kuvendit të Komunës”. Komuna e Malishevës qëndron mirë në këto fusha: “takime e seancave të hapura për publik”, “komitetet e hapura për publik”, “qasja në rregullore (vendimet) të Kuvendit Komunal (përsht. planet komunale)” “mbajtja e seancave të rregullta (10 në vit/5 në gjashtë mujorin e parë)” dhe “organizimi i Kuvendit të Komunës dhe përgjegjësit e mekanizmave të tij”. Tek “qasja në draft Rregulloret dhe planet”, “qasja në dokumente për shqyrtim në Komite”, “detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës” si dhe “Planin e reprimit për transparencë në Komunë” në këta indikatorë Kuvendi i Komunës së Malishevës nuk ka marrë asnjë notë të mundshme. Derisa tek “qasja në procesverbale të Kuvendit” dhe “qasja në rendin e ditës” Kuvendi i Komunës nuk ka marr notat maksimale pasi jo të gjitha procesverbalet janë të publikuara në këtë periudhë të vitit 2015 dhe qasja në rendin e ditës me materialet përcjellëse mbetet sfidë për transparencën e punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës.

“Transparenca e Ekzekutivit të Komunës”. është vlerësuar me 14.0 pikë, ku qëndron mirë në tre indikatorë: “zyrtarë për informim & koordinator për qasje në dokumente publike”, “konkurs për

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

punësim dhe kriteret ne ueb-faqe", "detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtorëve (Email adresa)", "vizita javore tek Kryetari). Komuna e Malishevës ka Shesin e Zyrës për Informim, zyrtarin për informim si dhe personin përgjegjës për qasje në dokumente publike. Komuna e Malishevës ka të shqyrtuara të gjitha kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe ka kthyer përgjigje duke refuzuar qasjen për një kërkessë, në ueb-faqe publikohen të gjitha konkurset dhe kriteret për pozitat përkatëse. Po ashtu, në ueb-faqe janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit, drejtorëve, email-at si dhe janë të publikuara edhe planet zhvillimore. Kryetari i Komunës së Malishevës gjithashtu ditën e premte të javës nga ora 13:00 ka caktuar si ditë për vizita nga ana e qytetarëve.

Komuna e Malishevës qëndron negativisht në disa indikatorë tek "*raporti gjashtë-mujor i punës*", "*raportimi i Kryetarit/es në Kuvend (2 herë në vit)*", "*lajme të subjekteve politike opozitare në Kuvend*", "*ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhë në përdorim)*", si dhe "*raportet për konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore*". Gjatë kësaj periudhe nuk ka publikuar në ueb faqe raportin e punës janar-qershor 2015, nuk është raportuar në Kuvendin e Komunës puna e Kryetarit për periudhën janar-qershor 2015, nuk ka raporte për konsultimet më publikun dhe dëgjimet buxhetore, nuk janë pasqyruar aktivitetet e opozitës në ueb faqe si dhe mungojnë informacionet bazike në gjuhët tjera zyrtare".

Komuna e Malishevës qëndron më dobët në disa indikatorë: "*niveli dhe afati ligjor i përgjigjes për qasje në dokumente zyrtare*", "*Planet Zhvillimore të Komunës (PZIU) & Plani Urban i Komunës*". Komuna e Malishevës gjatë kësaj periudhe nuk ka respektuar afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve për qasje në dokumente publike si dhe në mos ofrimin komplet të dokumentacionit të kërkuar për qasje në dokumente publike.

"Transparencia Financiare e Komunës". Komuna e Malishevës ka mjaft hapësirë për të qenë më e hapur dhe transparente. Malisheva ka marrë vlerësimin më të ulët krahasuar me shtyllat tjera të vlerësimit të kësaj komune duke marrë vetëm 9.3 pikë. Pikët maksimale ka marr tek "*ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin Komunal*" si dhe në "*publikimin e shpenzimeve tre mujore*". Komuna e Malishevës më dobët qëndron tek "*plani, buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapital*" duke mos publikuar planin, buxhetin dhe kohëzgjatjen e projekteve për vitin 2015 mirëpo përmes ueb faqes ka linkun e platformës së Institutit GAB që prezantohet buxheti i komunës së Malishevës për vitin 2015.

Komuna e Malishevës është vlerësuar negativisht në këta indikatorë: "*borxhi publik komunal (borxh kompanive)*", "*raporti i auditimit*", "*buxhetet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale dhe raportet e shpenzimeve*", "*të hyrat vetanake të komunës*", "*plani i prokurimi*", "*njoftimet për kontratë dhe për dhënen e kontratave*", "*publikimi i kontratave*" si dhe "*lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) në pronësi dhe të marra me qira për Komunën*". Në këta indikatorë komuna e Malishevës ka çaluar në periudhën janar-qershor 2015 duke mos i bërë publike përmes ueb faqës së komunës por edhe duke mos ofruar përgjigje në kërkesat e parashtruara për qasje në dokumente publike.

"Transparencia në Konsultime me Publikun". Në këtë gjashtë mujor Komuna e Malishevës ka marrë notë të lartë për Transparencë në *Konsultime me Publikum* duke qenë mjaft aktive në realizimin e takimeve të rregullta me qytetaret në fshatra dhe qytet, duke i realizuar 22 konsultime publike (15 konsultime në fshatra, 2 konsultime me qytetarë, 4 konsultime për rregulloret komunale në proces dhe 1 konsultim për buxhetin). Mjaft mirë qëndron edhe në informim të qytetarëve, përmes njoftimeve në

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

rrjete sociale, ueb faqe, shpalljet në komunë dhe bashkësi lokale.


Komuna e Malishevës qëndron negativisht në publikimin e “draft-rishikimit të buxhetit”, “materialin përcjellës pér qytetarët në dëgjimet buxhetore”, “rregullat e pjesëmarrijes së qytetarëve” si dhe në “linjë direkte pa pagesë pér brengat e qytetarëve”.

Vlen të theksohet që Komuna e Malishevës ka mbajtur më së shumti takime dhe konsultime publike në raport me komunat tjera të regionit të Prizrenit.

TRANSPARENCA NË RAHOVEC

Komuna e Rahovecit del të jetë komuna e tretë më transparentë në kuadër të komunave të regionit të Prizrenit me 40.3 % të nivelit të përgjigjëm bazuar në 44 indikatorë.

TRANSPARENCA NË RAHOVEC (PDK)



“Transparenca e Kuvendit të Komunës”. Kuvendi i Komunës së Rahovecit del të jetë më transparente në krahasim me komunat tjera të regionit të Prizrenit me 21.7 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Rahovecit qëndron mirë në “seancat e hapura pér publikun”, “qasje në rregulloret, vendimet dhe planet”, “mbajtjen e seancave të rregullta” si dhe “organizimi i Kuvendit dhe përgjegjësit e mekanizmave të tij”.

Relativisht mirë qëndron në këta indikatorë “komitetet e hapura pér publik”, “qasja në procesverbale” dhe “detajet biografike dhe email adresat të Anëtarëve të Kuvendit”. Komuna e Rahovecit duhet të shfojë përpjekjet në përmirësimin e transparencës në këtë indikatorë “qasje në draftet e rregulloreve dhe planeve”, “qasje në dokumente në shqyrtim tek Komitetet” si dhe “plani i Transparencës se Komunës”, ku gjatë periudhës janar-qershori 2015 këta indikatorë janë vlerësuar negativisht.

“Transparenca e Ekzekutivit”. Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 14.3 pikë është

QEVERISJA LOKALE DHE PËSËMARRJA QYTETARE

vlerësuar transparencia e ekzekutivit të Komunës së Rahovecit dhe në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës qëndron më dobët. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar "raportin gjashtë-mujor të Punës", nuk ka "raportuar Kryetari në Kuvend (2 herë në vit)", nuk ka "lajme të subjekteve politike opozitare në Kuvend" si dhe Komuna e Rahovecit nuk e ka "Zyrtarin për informim".

Komuna e Rahovecit qëndron mirë në tre indikatorë "konkurset për punësim dhe kriteret ne uebfaqe", "detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtoreve (Email adresa)" si dhe "Planet Zhvillimore të Komunës (PZH) & Plani Urban i Komunës". Gjatë kësaj periudhe Komuna e Rahovecit nuk ka publikuar në ueb faqe raportin e punës janar-qershor 2015, nuk është raportuar puna e Kryetarit në Kuvendin e Komunës për periudhën janar-qershor 2015, nuk ka në ueb faqe raporte për konsultimet më publikun dhe dëgjimet buxhetore, nuk janë pasqyruar aktivitetet e opozitës në ueb faqe si dhe mungojnë informacionet bazike në gjuhët tjera zyrtare.

"Transparenca Financiare e Komunës". Komuna e Rahovecit në transparencën financiare është vlerësuar me 17.0 pikë nga 35 të mundshmet dhe është njëra ndër komunat që në këtë periudhë është vlerësuar me më së shumti pikë.

Pikët maksimale ka marr tek "ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës" si dhe në "publikimin e shpenzimeve tre mujore", ofrimin e listës me "buxhetet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale dhe raportet e shpenzimeve" si dhe ofrimin e "listës së pronave (zyrat, lokalet, etj) në pronësi dhe të marra me qira për Komunën e Rahovecit".

Komuna e Rahovecit më dobët qëndron tek publikimi i "borxhit publik komunal (borxh kompanive), "raporti i auditimit", "të hyrat vetanake të komunës", "plani i prokurimi" si dhe "publikimi i kontratave". Në këta pesë (5) indikatorë Komuna e Rahovecit është vlerësuar me 0 pikë të mundshme.

"Transparenca në Konsultime me Publikun". Komuna e Rahovecit ka marrë 4.0 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Në këtë gjashtë mujorë në vazhdimësi ka respektuar kriteret ligjore në njoftimin e publikut për online dhe offline. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë konsoliduar Këshillat Lokal derisa nuk ka arritë që qeveria lokale të konsultohet për ndonjë politikë publike me këta organizma.

Komuna e Rahovecit qëndron negativisht në organizimin e "takimeve të rregullta me qytetarë", "organizimin e dëgjimeve publike për KAB", "rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve", publikimin e "draft rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2015", mungesën e një "linjë direkt pa pagesë për brengat e qytetarëve" si dhe mungesën e "rifreskimit të faqes së facebook-ut".


TRANSPARENCA NË PRIZREN

Në Transparometrin Komunal, që matë nivelin themelor të transparencës komunale, Komuna e Prizrenit nuk del të jetë mirë, kjo tregon që komunat nuk i kanë përsill rekomandimet që kanë dal nga raporti i KDI-së vitin e kaluar, për të përmirësuar transparencën në nivel lokal.

“Transparencia Financiare e Komunës”. Edhe në këtë gjashtë mujor Transparency financiare është shtylla me vlerësimin më të dobët në këtë komunë, ku është vlerësuar vetëm me 5 pikë. Sipas të dhënave të mbledhura për këtë hulumtim, vlerësimin më të lartë ka marr tek “*lista e pronave dhe aseteve të komunës*” dhe tek “*njoftimet për kontratë dhe për dhenien e kontratave*”, por jo të gjitha janë në përputhje me njoftimet e publikuara nga KRPP-ja.

Ndërsa mungesë të transparencës Komuna e Prizrenit ka treguar tek mos publikimi i të dhënave lidhur me buxhetin, kornizën afatmesme buxhetore si dhe planin e prokurimit, ndryshimet buxhetore, komuna po ashtu nuk ka publikuar raportin tre-mujor të shpenzimeve, të hyrat vetanake të komunës, borxhin publik komunal, buxhetin e ndërmarrjeve komunale dhe raportin e auditimit. Sa i përket Publikimi i kontratave kjo komunë nuk ka qenë transparente pasi nuk është përgjigjur ndaj kërkesës tonë.

TRANSPARENCA NË PRIZREN (PDK)



“Transparencia e Ekzekutivit”. Ekzekutivi i Komunës së Prizrenit në këtë Transparometër ka dalë të jetë më transparent në rapport me vitin e kaluar, *Transparencia e Ekzekutivit* është vlerësuar me 20 pikë, deri sa në rapportin e kaluar ka marr 13.7 nga 35 pikë maksimale. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që ka publikuar “*Planet Zhvillimore të Komunës*”, “*detajet biografike dhe Email adresat e Kryetarit dhe Drejtoreve*”, po ashtu ka publikuar në ueb faqe të gjitha “*konkurset e hapura dhe kriteret për pozitat përkatëse*”. Ndërsa më pak pikë ka marr tek “*raporti i punës*”, nga 13 drejtori që ka kjo komunë 5 prej tyre nuk kanë publikuar ne ueb faqe rapport të punës për vitin 2014, dhe tek “*zyrtari për informim dhe koordinator për qasje në dokumente publike*”, edhe pse kjo komunë ka zyrtar për informim por duke pas parasysh madhësinë e komunës ka mangësi. Po ashtu kryetari nuk ka

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

raportuar para kuvendit komunal për vitin 2014 .

Sa i përket publikimit të dhënave në gjuhët tjera zyrtare, kjo komunë qëndron mirë, pasi shumica e informatave në ueb faqe janë të përkthyera në gjuhën serbe dhe turke .

Komuna e Prizrenit për periudhën janar – prill 2015 ka pas gjithsej 61 kërkesa për qasje në DZ, prej tyre 11 kanë qenë të adresuara për prokurim publik .Por ajo çfarë mbetët e pa përmirësuar për këtë komunë është mos respektimi i afatit ligjor, dhe mos dërgimi i kérkesës tek drejtoritë përkatëse nga ana e komunës, por kjo kerkohet që të bëhet nga vet dërguesi i kérkesës.

Po ashtu kjo komunë nuk ka publikuar në ueb asnje raport nga konsultimet publike që ka mbajtur, ende Kryetari Komunës në bashkëpunim me kabinetin e tij nuk ka caktuar një ditë gjatë javës për t'i pritur qytetarët, si dhe nuk ka lajme të subjekteve opozitore në ueb faqen e komunës.

“Transparencia e Kuvendit të Komunës”. Është shtylla e dytë me nivel më të lartë të transparencës pas ekzekutivit. Komuna e Prizrenit qëndron mirë në këto fusha: “*takime e seancave të hapura për publik*”, transmetimi i tyre bëhet drejtpërdrejt përmes një televizioni lokal, “*komitetet e hapura për publik*”, “*mbajta e seancave të rregullta (10 në vit)*” dhe ‘*Plani i Veprimit për Transparency*’.

Për dallim nga 5 komunat tjera, Komuna e Prizrenit ka hartuar një plan. Në anën tjetër mungon “*qasja në procesverbale të Kuvendit*”, “*qasja në rendin e ditës së seancave*”, ku është publikuar vetëm një thirrje për rend të ditës, dhe nuk ka të publikuar “*biografin dhe të dhënrat kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit të Komunës*”.

Tek “*organizimi i Kuvendit komunal dhe përgjegjësit e mekanizmave të tij*”, “*qasja në draft-rregullore të Kuvendit Komunal (përsi planet komunale)*”, “*qasja në rregullore (vendimet) të Kuvendit Komunal (përsi planet komunale)*” “*detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit*”, Komuna e Prizrenit në këta indikator ka marr vlerësim më të dobët, pasi nuk janë publikuar të dhënrat e plota.

“Transparencia në Konsultime me Publikun”. Kjo komunë ka marrë 11 pikë nga 35.0 pikë të mundshme. Komuna e Prizrenit, ka mbajt “*takime me qytetaret në fshatra dhe qytet*”, përveç atyre të përcaktuara me ligj, takime tjera mbahen rrall, për këto takime njoftohet paraprakisht publiku *online* dhe *offline* (në formë elektronike dhe të shkuar). Por para miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), kjo komunë nuk ka organizuar asnje dëgjim me qytetarët. Ndërsa konsolidimi i këshillave të fshatrave dhe bashkësive lokale në qytet ende nuk është bërë, pasi nuk ka pas një rregullore komunale, pas miratimit të rregullores gjatë këtij viti, është formuar një komision nga Kuvendi i Komunës dhe sa kanë filluar të punojnë.


Tani më Komuna e Prizrenit ka hapur një llogari në rrjetin social facebook dhe është aktive në ndarjen e informatave, por krahasuar me numrin banorëve kjo komunë ka numër të vogël të pëlgimeve në facebook, duhet ta promovojoj më shumë këtë llogari. Po ashtu kjo komunë nuk e ka publikuar draft-rishikimin e buxhetit në ueb-faqe, si dhe nuk ka një një linjë direkte telefonike pa pagesë të hapur për qytetarëve .

(D)

TRANSPARENCA NË SUHAREKË

Komuna e Suharekës del të jetë komuna e katërt më transparentë në kuadër të komunave të regjionit të Prizrenit me 34.1 % të nivelit të përgjigjëm bazuar në 44 indikatorë.

TRANSPARENCA NË SUHAREKË (LDK)



“Transparenca e Kuvendit të Komunës”. Komuna e Suharekës është vlerësuar me 18.0 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Suharekës qëndron mirë në “qasja në rendin e ditës”, “seancat e hapura për publikun”, “komitetet e hapura për publikun”, “qasja në procesverbale”, “mbajtjen e seancave të rregullta” si dhe “organizimi i Kuvendit dhe përgjegjësit e mekanizmave të tij”. Komuna e Suharekës është komuna e vetme në regjion të Prizrenit për qasje të plotë në rendin e ditës dhe materialet përcjellëse për shqyrtim në seancat e Kuvendit të Komunës.

Tek “qasja në draft Rregulloret dhe planet”, “detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës” si dhe “planin për Transparencë në Komunë” Kuvendi i Komunës së Suharekës nuk ka marrë asnjë notë të mundshme.

“Transparenca e Ekzekutivit”. Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 15.7 pikë është vlerësuar transparenca e ekzekutivit të Komunës së Suharekës dhe nga të dhënrat finale del që ekzekutivit i komunës qëndron me dobët në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës.

Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar në ueb faqe “raportin gjashtë-mujor të Punës”, nuk ka “raportuar Kryetari në Kuvend (2 herë në vit)”, nuk ka “lajme të subjekteve politike opozitare në Kuvend” si dhe Komuna e Suharekës nuk ka publikuar dhe lejuar qasje në “raportet në konsultimin e publikut dhe dëgjimet buxhetore”.

Komuna e Suharekës qëndron mirë në katër (4) indikatorë “konkurset për punësim dhe kriteret ne ueb-faqe”, “detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtoreve (Email adresa), “Planet Zhvillimore të Komunës (PZHU) & Plani Urban i Komunës” si dhe “Zyrtarë për informim & Koordin. për qasje në dokumente publike”.

(D)

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

“Transparenca Financiare e Komunës”. Komuna e Suharekës në transparencën financiare është vlerësuar me 5.0 pikë nga 35 të mundshmet. Gjatë kësaj periudhe, Komuna e Suharekës është vlerësuar me pikë maksimale vetëm tek “*ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës*”, derisa tek “*publikimi i njoftimeve për kontratë dhe dhënie të kontratës*” po ashtu është vlerësuar me dy pikë duke bërë që Komuna e Suharekës nga 11 indikatorë të kësaj shtylle të ketë nota pozitive vetëm në dy indikatorë. Kësisoj, kjo komunë duhet të shtoje përpjekjet e saj në rritjen e transparencës financiare.

Komuna e Suharekës dobët qëndron tek publikimin e “*borxhit publik komunal (borxh kompanive)*” publikimi në ueb faqe të “*raporteve tre mujore financiare*” publikimin e “*raportit të auditimit*”, publikimin e “*borxhet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale dhe raportet e shpenzimeve*”, lejimin e qasjes dhe publikimi i “*listës së pronave (zyre, lokalet etj) në pronësi dhe të marra me qira për Komunën*” publikimin e “*të hyrat vetanake të komunës*”, publikimin e “*planin, buxhetin dhe kohëzgjatjen e projekteve kapitale*” publikimin e “*planit të prokurimi*” si dhe “*publikimin e kontratave*”. Në këta nëntë (9) indikatorë Komuna e Suharekës është vlerësuar me 0 pikë të mundshme.


“Transparenca në Konsultime me Publikun”. Kjo komunë ka marrë 9.0 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Komuna e Suharekës në këtë gjashtë mujorë në vazhdimësi ka respektuar kriteret ligjore në njoftimin e publikut online dhe offline si dhe ka ri freskuar në vazhdimësi faqen e facebook-ut.

Komuna e Suharekës qëndron negativisht në “*takimet e rregullta me qytetarë*”, “*organizimin e dëgjimeve publike për KAB*”, “*rregullat e pjesëmarries së qytetarëve*”, “*material përcjellës për qytetarët në dëgjimet buxhetore*”, mungesa e “*linjës direkte pa pagesë për brengat e qytetarëve*”, mungesa e publikimit në ueb faqe të “*draft rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2015*”.

TRANSPARENCA NË DRAGASH

Komuna e Dragashit del të jetë komuna e pestë më transparentë në kuadër të komunave të regjionit të Prizrenit me 21.0 % të nivelit të përgjigjëm bazuar në 44 indikatorë.

TRANSPARENCA NË DRAGASH (PDK)



"Transparenca e Kuvendit të Komunës". Komuna e Dragashit është vlerësuar me 13.7 pikë nga 35.0 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Dragashit qëndron mirë vetëm në "seancat e hapura për publikun", "mbajtjen e seancave të rregullta" si dhe "organizimi i Kuvendit dhe përgjegjësit e mekanizmave të tij" duke marrë pikët maksimale të vlerësimit.

Tek "qasja në procesverbalet", "qasja në draft rregulloret dhe planet", "detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës" si dhe "planin për Transparencë në Komunë" Kuvendi i Komunës së Dragashit nuk ka marrë asnjë notë të mundshme.

"Transparenca e Ekzekutivit". Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 6.7 pikë është vlerësuar transparenca e ekzekutivit të Komunës së Dragashit dhe në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës qëndron shumë më dobët. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar në ueb faqe "raportin gjashtë-mujor të Punës", nuk ka "raportuar Kryetari në Kuvend (2 herë në vit)", nuk ka në ueb faqe "lajme të subjekteve politike opozitare në Kuvend", nuk ka "zyrtarë për informim dhe koordinator për qasje në dokumente publike".

Kryetari i Komunës nuk praktikon pranimin e "vizitave javore për qytetarët", mungon publikimi në ueb faqe të "konkurseve për punësim dhe kriteret", mungojnë "Planet Zhvillimore të Komunës (PZHK) dhe Plani Urban i Komunës", nuk ka "lajme të subjekteve opozitare në Kuvend" si dhe Komuna e Dragashit nuk ka publikuar dhe lejuar qasje në "raportet në konsultimin e publikut dhe dëgjimet buxhetore". Nga 11 indikatorë vlerësues në transparencën e ekzekutivit të komunës, vetëm në 4 indikatorë komuna e Dragashit ka qenë transparente duke marrë nota pozitive derisa në 7

QEVERISJA LOKALE DHE PËJSEMMARRJA QYTETARE

indikatorë tjerë janë vlerësuar negativisht në këtë komunë.

“Transparenca Financiare e Komunës”. Komuna e Dragashit në transparencën financiare është vlerësuar me 3.0 pikë nga 35 pikë të mundshme. Pikët maksimale ka marr tek “ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin Komunal”.


Komuna e Dragashit qëndron tejet dobët tek publikimi i “borxhit publik komunal (borxh kompanive)”, publikimi i “raportit të auditimit”, publikimi dhe lejimi i qasjes në “borgjet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale dhe raportet e shpenzimeve”, publikimi dhe lejimi i qasjes në “listat e pronave (zyrat, lokalitet etj) në pronësi dhe të marra me qira për Komunën”, publikimi i “plani, buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale”, publikimi i “të hyrave vetanake të komunës”, publikimin i “planit të prokurimi”, publikimi i “njoftimeve për kontratë dhe për dhënien e kontratës” si dhe në “publikimin e kontratave”. Në këta nëntë (9) indikatorë Komuna e Dragashit është vlerësuar me 0 pikë të mundshme duke bërë që kjo komunë të mos cilësohet në asnjë rrëthanë transparente në fushën e shpenzimit dhe planifikimit financiarë.

“Transparenca në Konsultime me Publikun”. Komuna e Dragashit ka marrë 4.3 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Komuna e Dragashit në këtë gjashtë minimalisht ka respektuar kriteret ligjore në njoftimin e publikut për online dhe offline.

Komuna e Dragashit qëndron negativisht në “takimet e rregullta me qytetarë”, “organizimin e dëgjimeve publike për KAB”, “rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve”, “material përcjellës për qytetarët në dëgjimet buxhetore”, mungesa e “linjës direkte pa pagesë për brengat e qytetarëve”, mungesa e publikimit të “draft rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2015”. Bazuar në vlerësimin negativ për periudhën janar-qershor 2015 në shumicën e indikatorëve në shtyllën e transparencës së komunës në konsultime me publikun, mund të themi që kjo komunë fare pak ka bërë përpjekë në përmirësimin e transparencës dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen komunale.

Komuna e Mamushës del të jetë komuna me më së paku transparencë në kuadër të komunave të regionit të Prizrenit me 19.8 % të nivelistë përgjigjëm bazuar në 44 indikatorë. Për komunën e Mamushës mbetet sfiduese edhe qasja në rendit e ditës dhe publikimi i procesverbaleve përmes ueb faqes si një nga elementet thelbësor të transparencës së punës të institucioneve lokale.

TRANSPARENCA NË MAMUSHË (KTAP)



“Transparenca e Kuvendit të Komunës”. Komuna e Mamushës është vlerësuar me 13.0 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Mamushës qëndron mirë vetëm në “seancat e hapura për publikum”, “mbajtjen e seancave të rregullta” si dhe “organizimi i kuvendit dhe përgjegjësit e mekanizmave të tij” duke marrë pikët maksimale të vlerësimit.

Tek “qasja në rendin e ditës”, “qasja në procesverbalet”, “qasja në draft rregulloret dhe planet”, “qasja në dokumentet për shqyrtim të Komitetet”, “detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës” si dhe “planin për Transparencë në Komunë” Kuvendi i Komunës së Mamushës nuk ka marrë asnjë notë të mundshme.

“Transparenca e Ekzekutivit”. Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 4.0 pikë është vlerësuar transparenca e ekzekutivit të Komunës së Mamushës dhe në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës qëndron shumë më dobët. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar “raportin gjashtë-mujor të Punës”, nuk ka “raportuar Kryetari në Kuvend (2 herë në vit)”, nuk ka “lajme të subjekteve politike opozitare në Kuvend”, nuk ka “zyrtarë për informim dhe koordinator për qasje në dokumente publike”, Kryetari i Komunës nuk praktikon pranimin e “vizitave javore për qytetarët”, mungon publikimi në ueb faqe të “konkurseve për punësim dhe kriteret”, mungojnë “Planet Zhvillimore të Komunës (PZHK) dhe Plani Urban i Komunës”, nuk ka “lajme të subjekteve opozitare në Kuvend” si dhe Komuna e Mamushës nuk e ka publikuar dhe lejuar qasje në “raportet në konsultimin e publikut dhe dégjimet buxhetore”.

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

“Transparenca Financiare e Komunës”. Komuna e Mamushës është plotësisht jo transparente tek financat komunale dhe del të jetë me performance shumë të dobët me vetëm 6.0 pikë nga 35 pikët e mundshme në këtë shtyllë. Asnjë dokument finanziar, raport i shpenzimeve apo të tjetër finanziar apo buxhetor nuk është i qasshëm në këtë komunë. Të vetmen pikë maksimale në periudhën janar-qershori 2015 që ka marrë Komuna e Mamushës në transparencën finanziare mbetet ndryshimi buxhetor i miratuar nga Kuvendi i Komunës (rishikimi i buxhetit).

“Transparenca në Konsultime me Publikun”. Kjo komunë ka marrë 4.7 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Gjatë kësaj periudhe Komuna e Mamushës ka mbajtur një dëgjim publik për buxhetin e komunës, ka bërë publike përmes formos online dhe offline organizimin e dëgjimit publik si dhe në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi ka përfaqësues nga Organizatat e Shoqërisë Civile.



Mungesa e takimeve të rregullta me qytetarë, mungesa e materialeve përcjellëse për qytetarët në dëgjimet buxhetore, mungesa e konsolidimit dhe konsultimit të bashkësive lokale, mungesa e organizimit të takimeve me OSHC-t, mungesa e publikimit të draft rishikimit ne ueb faqen e komunës si dhe mungesa e një ueb faqe në rrjetin social të Komunës së Mamushës paraqesin indikatorët kyç që kjo komunë mbetet larg praktikave të mira në qasjen e qytetarëve në konsultim dhe informim për politikat publike.

QASJA NË RRJETE SOCIALE

Bazuar në të dhënat e disponueshme në Kosovë, interneti ka përdorim mjaftë të lartë, duke arritur shifrën 76.62% të popullsisë totale në Kosovë. Duhet thënë se kjo shifër është e përafërt me përdorimin e internetit në vendet e Bashkimit Evropian. Duke parë se përdorimi i internetit kap shifra shumë të mëdha, në fakt pjesën dërrmuese të qytetarëve të Kosovës, atëherë institucionet mund ta përdorin këtë gjë si një mundësi, për t'i informuar qytetarët mbi punën e institucioneve komunale. Përkundër që shumica e komunave kanë ueb faqe, ato nuk janë edhe aq të vizituara nga qytetarët, përveç në rastet kur të njëjtit kërkojnë ndonjë dokument apo shërbim specifik nga këto ueb faqe. Tri nga komunat e regionit të Prizrenit me vetë iniciativë kanë filluar që të përdorin Facebook-un si një përshtatisje e mundur për të informuar qytetarët në lidhje me punët e komunës. Kjo përshtatisje jo të gjitha institucionet komunale kanë një faqe në Facebook dhe ato të cilat tani më kanë hapur, kanë dallime të mëdha në formën e menaxhimit të këtyre faqeve.

Facebook ka disa avantazhe në raport me ueb faqet, pasi që përmes llogarisë në Facebook komunat mund të postojnë lajmet dhe informatat aty ku është audiencia, pa pasur nevojë që ata të kërkojnë për lajmet. Me Facebook, informata u shërbehet audiencës aty ku ata kalojnë kohën. Facebook për dallim nga ueb faqet aktuale të komunave, lejon interaktivitet në mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të komunës dhe madje është efikas edhe në bllokimin e komenteve ofenduese apo të përsëritshme. Me gjithë avantazhet e Facebook-ut, rrjetet sociale asnjëherë nuk mund zëvendësojnë ueb faqet tradicionale.

KOMUNANERRJETESOCIALE / FACEBOOK



Përveç shpërndarjes efektive të lajme, Facebook nuk mund të zëvendësoj shërbimet e ueb faqeve dhe të dhënave të cilat mund të merren nga aty. Për shembull të dhënat për buxhetin, raportet financiare, profilet e përfaqësuesve të komunës, kontaktet etj, është shumë e vështirë të ruhen në Facebook. Madje përmes ueb faqeve disa shërbime të aplikimit online për dokumente, në asnjë mënyrë nuk mund të zëvendësohen nga llogaritë e komunave në Facebook. Ideale për komunitat do të ishte që

QEVERTISJA LOKALE DHE PËRSHTATSHËM QYTETARE

llogaritë në Facebook, t'i shërbejnë ueb faqeve aktuale për t'i shërbyer lajmet në mënyrë sa më efektive tek audiencia e targetuar, gjë për të cilën Facebook është shumë i përshtatshëm.

Nga monitorimi që u është bërë komunave për këtë periudhë, kemi vërejtur se nga gjashtë (6) komunat e monitoruara, tri (3) prej tyre tanë më kanë hapur llogari në Facebook. Komunat që ende nuk kanë një të tillë janë: Rahoveci, Dragashi dhe Mamusha. Ndërkohë që Prizreni, Suhareka dhe Malisheva, tanë më kanë llogaritë përmes të cilave informojnë qytetarët për ngjarje në kuadër të komunës.

Për t'i krahasuar komunat se sa suksesshëm menaxhojnë më llogaritë e tyre në Facebook, ne kemi matur numrin e pëlqimeve (Likes) që ato kanë, dhe kemi pjesëtarët këtë numër me numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës përkatëse.

Në këto krahasime, kemi parë se Komuna e Malishevës e cila ka 3,622 pëlqime, ka numrin më të madh krahasuar me popullsinë, pasi që atë e përcjellin 6 % e qytetarëve të kësaj komune. Pas Malishevës, komuna me numër më të madh të pëlqimeve apo qytetarëve që e ndjekin në Facebook është Suhareka, e cila ka 2,549 pëlqime apo 4 % të popullsisë. Komuna e Prizrenit ka numrin më të vogël të pëlqimeve në total 1,827 pëlqime, mirëpo krahasuar me numrin e popullsisë, del se vetëm 1 % e qytetarëve e përcjellin komunën përmes Facebook-ut. Komuna e Rahovcit, Dragashit dhe Mamushës nuk kanë fare llogari në Facebook.

Shikuar në përgjithësi, tri (3) nga komunat e monitorura kanë llogari në Facebook mirëpo me numër të vogël të qytetarëve të cilat i përcjellin.

REKOMANDIMET

REFORMIMI I MENAXHIMIT TË UEB-FAQEVE

1. **MAP të decentralizojë menaxhimin e ueb-faqeve:** MAP duhet të decentralizojë menaxhimin e ueb-faqeve komunale tek komunat në mënyrë që të kenë më shumë liri në organizimin e informatave që ndajnë me qytetarë përmes ueb-faqeve dhe përshtatjen e tyre për popullatën e vetë. Komunat e dinë më së miri se çfarë karakteri i ueb-faqes do duhej ta kishin dhe si ti bënin atraktive për lajme;
2. **Ueb-faqet të lidhura me rrjete sociale:** Ueb-faqet do duhet të ishin të lidhura me rrjetet sociale Facebook dhe Twitter që lajmet, planet dhe dokumentet kryesore të ngarkuara në ueb-faqe komunale do të ndaheshin edhe përmes rrjeteve sociale ku audiencia është më e madhe dhe mundësia e komentimit dhe përfshirjes qytetare është më e madhe;
3. **Hapësirë më e madhe punës së Kuvendit Komunal:** Ueb-faqet zyrtare të Komunave për shkak se administrohen nga Zyra e Kryetarit nuk u japid shumë rëndësi dhe vëmendje punës së Kuvendit Komunal. Disa komuna kanë mungesë të informatave për anëtarët e Kuvendit si dhe kontaktet e këtyre përfaqësuesve lokal ndërsa tek pjesa e lajmeve nuk gjinden deklaratat apo aktivitetet e subjekteve të përfaqësuara në Kuvend, sidomos atyre opozitare. Ekziston një link në gjithë platformën e ueb-faqeve që u dedikohet Kuvendeve Komunal dhe kjo rrallë rifreskohet. Po thuajse e gjithë pjesa tjeter e faqes i dedikohet punëve dhc vendimeve të Ekzekutivit.
4. **Hapësirë për aktivitete të opozitës:** Komunat duhet të ndajnë edhe deklarimet e aktivitetet e subjekteve politike opozitare në ueb-faqen e tyre dhe Kryetarët e komunave mos të personalizojnë ueb-faqet për lajme vetëm të tyre apo subjekteve të tyre;

DOKUMENTE LEHTË TË QASSHME ONLINE

5. **Planet e projekteve kapitale të shpërndahen aktivisht:** Planet e projekteve kapitale duhet të bëhen publike përmes ueb-faqes, rrjeteve sociale dhe lokacioneve publike që të informohen qytetarët para se të kontraktohet projekt. Në këtë mënyrë qytetarët do të janë të informuar për të shprehur mendimet dhe shqetësimet e tyre dhe të janë të dinë se çfarë projekt do të realizohet në lagjet dhe fshatrat e tyre e jo të mbasin në terr informativ deri sa të realizohet projekt komplet, apo të shfaqen problem dhe pengesa nga qytetarët në mes të projektit;
6. **Dokumentet publike në ueb-faqe zyrtare:** Komuna duhet ti ketë lehtë të qasshme në ueb-faqe dokumentet kyçe si raportet tre-mujore të shpenzimeve, buxhetin e komunës, kornizën afatmesme të buxhetit, listën e projekteve kapitale dhe listën e aseteve komunale dhe objekteve nën pronësi komunale, në mes tjera. Nuk mjafton që këto dokumente të janë publike vetëm me kërkësë, pasi që kemi një avancim teknologjik dhe qasjes së përhapur të internetit ku informatat mund të ndahen lehtë dhe shpejt;
7. **MAPL të insistojë në publikim të dokumenteve kyçe:** MAPL, si mbikëqyrëse dhe përkrahëse e nivelit lokal, duhet të jetë më aktive në insistimin që komunat të publikojnë raportet tre-mujore të shpenzimeve, listën e projekteve kapitale dhc buxhetet komunale, pasi që janë dokumente me rëndësi të madhe për njostimin e qytetarëve me punën e institucioneve të tyre lokale;

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

TRANSPARENCE BUXHETORE PËR PJESËMARRJE QYTETARE

8. **Fushatë për kërkesat e qytetarëve për draft-buxhet:** Zyra e Kryetarit duhet të ndërmarrë një fushatë informues para se të mbahen dëgjimet publike për buxhet në mënyrë që të ketë njoftim të mirëfilltë për pjesëmarrje qytetare, të njoftohet publiku për rregullat e pjesëmarrjes në dëgjime buxhetore dhe të dihen temat e buxhetit në fokus. Kjo fushatë duhet të filloj nga muaji qershor, kur edhe pritet të diskutohet dhe miratohet Korniza Afat-Mesme e Shpenzimeve (tre-vjeëare) që pastaj përcjellët me buxhetin e viti të ardhshëm.
 9. **Dokumentet të jenë publike në fazën e draftimit:** MAPL duhet të lejojë komunat që të publikojnë aktet komunale edhe si draft e jo vetëm 15 ditë pas miratimit;
 10. **Trajnime të zyrtarëve komunale për ndërlidhje me qytetarë:** MAPL duhet të organizojë trajnime për Zyrtarët për Informim për llojin e dokumenteve që duhet të ndahen në ueb-faqe dhe mënyrën se si duhet të ndahen në ueb-faqe, po ashtu edhe për përgjigjen e kërkesave në dokumente publike;

RI-ORGANIZIM INSTITUCIONAL PËR AVANCIM TË TRANSPARENCEËS

11. **Resurse për Kuvendet Komunale:** Kuvendet komunale kanë nevojë për më shumë resurse humane dhe kapacitete teknike për të përpunuar dhe ndarë informatat e Kuvendit dhe mos të mbeten nën mëshirën e zyrës së Kryetarit;
 12. **Mekanizëm komunal për vetëvlerësim:** Komunat duhet të fillojnë të përdorin një mjet të vetë-vlerësimit të nivelit të transparencës në institucionin e tyre dhe të vërejnë pikat e dobëta dhe mangësitë e tyre në transparencë që të mund të përmirësohen në qeverisje; Transparometri është një mekanizim i mirë themelor për vetëvlerësim të komunave;
 13. **Ndarje të përvojave ndër-komunale për transparencë:** Zyrtarët komunal të komunikojnë më shumë në mes veti për të marrë përvojat e mira.

KOMUNA E MALISHEVËS

- **Qasje në draft rregulloret dhe planet e komunës.** Komuna e Malishevës duhet të krijojë hapsirë qytetarëve që të përfshihen në fazën e hershme të draft rregulloreve dhe planeve të komunës duke i mundësuar qytetarëve përmes ueb faqës draf dokumentet e tillë.
 - **Detajet biografike dhe kontaktet e Anëtarëve të Kuvendit:** Kuvendi Komunal duhet të bëjë publike detajet biografike dhe të dhënrat kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit;
 - Miratimi i Planit për transparencë në komunës. Komuna e Malishevës duhet të përshpejtojë procedurat në draftimin dhe miratimin e Planit për Trasparencë në Komunë.
 - **Publikimi i raporteve nga konsultimet publike.** Edhe përkundër mbajtjes së takimeve dhe konsultimeve të shumta me qytetarë, komuna e Malishevës nuk ka ofruar asnjë raport nga këto takime dhe konsultime si dhe nuk ka ofruar qasje përmes kërkesës fizike. Komuna e Malishevës duhet të praktikojë mbajtjen e procesverbaleve nga takimet dhe konsultimet publike.
 - **Publikimi i dokumenteve për transparencë:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe Borxhin Publik Komunal, Raportin e Auditimit, Buxhetet e ndërmarrjeve komunale, rajonale dhe raportet tre-mujore e shpenzimve, raportin gjashtë mujor të punës, njostimet për kontratë dhe dhëni e kontratës si dhe duhet te publikojë Planin e Prokurimit; dhe të njëjtat ti publikojë në ueb faqen e komunës.
 - **Ueb faqja në gjuhët zyrtare.** Komuna e Malishevës duhet të përditësoj të dhënrat në ueb faqe

(D)

edhe në gjuhë tjetër zyrtare.

- **Linjë Telefonike direkte gratis:** Zyra e Kryetarit të ketë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, mundësish gratis për qytetarët, që të mund të bëjnë kërkesat e tyre lehtë, jashtë propozime dhe të udhëzohen përmes telefonit për qasje në informata publike;
- **Materiali përcjellës në dëgjime publike:** Në konsultimet për buxhet, Komuna e Malishevës duhet të ofrojë pjesëmarrësve një përbledhje të propozim-buxhetit komunal që të shihen qartë planifikimet e projekteve, planifikimet e shpenzimeve dhe shumat e planifikuar për vija buxhetore.
- **Hapësirë aktiviteteve të opozitës:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë edhe lajmë të aktiviteteve të opozitës, dhe duhet të gjitha informatat ti ketë të përkthyera edhe në gjuhën tjeter zyrtare, gjuhën serbe.
- **Qasje e planifikimeve buxhetore në ueb:** Zyra e Kryetarit duhet ti bëjë lehtë të qasshme në ueb-faqe, Kornizën Afatimesme të Shpenzimeve, propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm dhe listën e projekteve kapitale; Po ashtu duhet të jenë transparente edhe plani i prokurimit dhe njoftimet për kontrata si dhe njoftimet për dhënien e kontratave;

KOMUNA E PRIZRENIT

- **Rapoçojë aktivitetin gjashtë-mujor:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë raportet gjashtë-mujor të punës së kryetarit dhe Kryetari duhet të rapoçojë para anëtarëve të Kuvendit për situatën socio-ekonomike dhe për buxhet, jo përmes drejtoreve komunal;
- **Linjë telefonike direkte gratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën;
- **Takime javore me qytetarë:** Kryetari duhet të caktojë një ditë në javë në të cilën ai ndan kohën për shqetësimet e qytetarëve si dhe duhet të marrë pjesë në konferencë për media për ti informuar qytetarët se me çka është duke u marrë komuna e tyre;
- **Transparenca e shpenzimeve komunale:** Zyra e Kryetarit duhet të publikoj në ueb-faqe borxhin publik komunal, raportet e shpenzimeve, të hyrat vetanake të komunës, planin e prokurimit, planin, buxhetin dhe kohëzgjatjen e projekteve kapitale;
- **Kuvendi i Komunës të hapet për publik:** Kuvendi i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe rendin e ditës së seancave, të gjitha procesverbalet e Kuvendit si dhe të publikojë draft-rregullloret e Kuvendit Komunal për çdo vit. Organizimi i Kuvendit të Komunës dhe përgjegjësitë e mekanizmave të tij duhet të jenë të publikuara në mënyrë të detajuar dhe duhet të përfshihet organogrami i cili ende mungon, po ashtu duhet të publikohen detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit dhe e-mail adresat e tyre;
- **Bashkëpunim me Bashkësi Lokale për Transparencë:** Kuvendi Komunal i Prizrenit duhet sa më parë të filloj me konsolidimin e bashkësive lokale si dhe të përpiloj rregull të pjesëmarrjes së qytetarëve, dhe
- **Zbatojë ligjin për qasje në dokumente publike:** Zyra për Informim duhet të zbatojë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike si e specifikon Neni 5.2 dhe 5.3, pra duke i drejtar vëtë kërkesat pa pasur nevojë që të kërkoj nga qytetarët të shkojnë tek njësitet tjera të komunës. Zyrtari për dokumente duhet të përgatit dokumentet e kërkuar për qytetarët dhe dërguar kërkuesit direkt dhe mos të shërbej vetëm si orientim për tek drejtore të dërguar kërkuesit direkt dhe komplikon qasjen në dokumente zyrtare, e tej-zgjatë kohën e qasjes në dokumente.

(D)

KOMUNA E RAHOVECIT

- **Raportoj aktivitetin gjashtë-mujor:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe reportin gjashtë-mujor të punës, raportet për konsultime me publikun dhe dëgjimet buxhetore, planet zhvillimore të Komunës, lajme të subjekteve politike opozitare në kuvend, dhe informata transparente edhe në gjuhët tjera zyrtare.
- **Qasje në draft rregulloret dhe planet e komunës.** Komuna e Rahovecit duhet të krijojë hapsirë qytetarëve që të përfshihen në fazën e hershme të draft rregulloreve dhe planeve të komunës duke i mundësuar qytetarëve përmes ueb faqes draft dokumentet e tillë.
- **Buxhetet e ndërmarrjeve nën mbikëqyrje:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe Borxhin Publik Komunal, Raportin e Auditimit, të hyrat vetanake. Buxhetet e ndërmarrjeve komunale, rajonale, dhe duhet të publikojë Planin e Prokurimit;
- **Bashkëpunim me Bashkësi Lokale për Transparencë:** Komuna duhet të fillojë konsultimin e të gjitha bashkësive lokale që informatat e komunës të ndahen në mënyrë më efektive në komunitete të komunës dhe të kanalizohen më mirë kërkesat e qytetarëve nga e gjithë komuna;
- **Linjë telefonike direkte gratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte për brengat e qytetarëve, dhe të mbajë takime me organizata të shoqërive civile.
- **Takime javore me qytetarë:** Kryetari i Komunës duhet ta rezervojë një ditë në javë për vizita me qytetarë që kanë kërkesa dhe propozime për komunën e tyre;

KOMUNA E SUHAREKËS

- **Qasje në draft të buxhetit:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe draftin e buxhetit të vitit të ardhshëm, listën e aseteve komunale, shpenzimet dhe buxhetin e detajuara të ndërmarrjeve komunale, planin e prokurimit si dhe raportin e auditimit të vitit paraprak në ueb-faqe; Komuna pasi që të bëhen kërkesat zyrtare duhet të jetë e gatshme të dërgojë shpenzimet dhe buxhetet e ndërmarrjeve komunale, rajonale;
- **Detajet biografike dhe kontaktet e anëtarëve të Kuvendit:** Kuvendi i Komunës duhet të bëjë publike detajet biografike dhe të dhënët kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit si dhe organogramin e institucioneve lokale që qytetarët e interesuar të mund të orientohen më lehtë;
- **Planin për transparencë në Komunë:** Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës duhet të shtojnë përpjekjet në hartimin dhe miratimin e Planit për Transparencë në Komunë.
- **Qasje në draft rregulloret dhe planet e komunës.** Komuna e Malishevës duhet të krijojë hapësirë qytetarëve që të përfshihen në fazën e hershme të draft rregulloreve dhe planeve të komunës duke i mundësuar qytetarëve përmes ueb faqës draft dokumentet e tillë.
- **Publikimi i raporteve nga takimet dhe konsultimet me publikun.** Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës duhet të kujdesen në publikimin e raporteve nga takimet dhe konsultimet me publikun.
- **Hapësirë aktivitetave të opozitës:** Komuna duhet të publikojë edhe lajme për aktivitetet e opozitës dhe duhet të përkthehen të gjitha informatat edhe në gjuhët tjera zyrtare.
- **Takime e rregullta me qytetarë:** Kryetari i Komunës duhet të organizojë takime të rregullta me qytetarë; të organizojë dëgjimet buxhetore dhe të pisën qytetarët me materiale përcjellës në dëgjimet buxhetore
- **Linjë Telefonike direkte gratis:** Zyra e Kryetarit të ketë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, mundësish me grati për qytetarët, që të mund të bëjnë kërkesat e tyre lehtë, jepin propozime dhe të udhëzohen përmes telefonit për qasje në informata publike;

KOMUNA E DRAGASHIT

- **Transparenca e shpenzimeve komunale:** Transparenca financiare duhet të irritet ndejshëm pasi që Zyra e Kryetarit duhet ta publikojë në ueb-faqe raportet e shpenzimeve, të hyrat veta nake të komunës, planin, buxhetin dhe kohëzgjatjen e Projekteve kapitale, planin e prokurimit si dhe njoftimet për kontratë dhe dhënien e kontratave;
- **Qasja në procesverbale dhe në draft rregulloret dhe planet.** Transparenca e punës së Kuvendit të Komunës duhet të irritet përmes publikimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Kuvendit, duhet të irritet qasja e qytetarëve në draft rregulloret dhe planet komunale përmes ueb faqës.
- **Detajet biografike dhe kontaktet e anëtarëve të Kuvendit:** Kuvendi i Komunës duhet të bëjë publike detajet biografike dhe të dhënat kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit si dhe organogramin e institucioneve lokale që qytetarët e interesuar të mund të orientohen më lehtë;
- **Planin për transparencë në Komunë:** Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës duhet të shtojnë përpjekjet në hartimin dhe miratimin e Planit për Transparencë në Komunë.
- **Regrutimi i Zyrtarit për Informim:** Kryetari i Komunës së Dragashit duhet të fillojë procedurat e regrutimit të Zyrtarit për Informim, nëse kjo nuk është e mundshme duhet të riorganizoje stafin e shërbyses civile me qëllim të plotësimit të kësaj pozite;
- **Qasje në draftin e Buxhetit:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe draftin e buxhetit të vitit të ardhshëm, listën e aseteve komunale, shpenzimet dhe buxhetin e detajuara të ndërmarrjeve komunale, planin e prokurimit si dhe raportin e auditimit të vitit paraprak në ueb-faqe; Komuna pasi që të bëhen kërkesat zyrtare duhet të jetë e gatshme të dërgojë shpenzimet dhe buxhetet e ndërmarrjeve komunale, rajonale;
- **Raportim para përfaqësuesve lokal:** Kryetari i Komunës duhet të raportoj para kuvendit dy herë në vit ashtu siç edhe parashihet me ligj dhe duhet të mbajë konferenca për media
- **Hapësirë aktivitetave të opozitës** Komuna duhet të publikojë edhe lajme për aktivitetet e opozitës dhe duhet të përkthehen të gjitha informatat edhe në gjuhët tjera zyrtare.
- **Takime e rregullta me qytetarë:** Kryetari i Komunës duhet të organizojë takime të rregullta me qytetarë; të organizojë dëgjimet buxhetore dhe të pisen qytetarët me materiale përcjellës në dëgjimet buxhetore
- **Linjë Telefonike direkte gratis:** Zyra e Kryetarit të ketë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, mundësishët gratis për qytetarët, që të mund të bëjnë kërkesat e tyre lehtë, jepin propozime dhe të udhëzohen përmes telefonit për qasje në informata publike;
- **Bashkëpunim me Bashkësi Lokale për Transparencë:** Kuvendi Komunal duhet të bëje konsultimin e bashkësive lokale si dhe duhet të mbajë takime me organizatat e shoqërisë civile.

KOMUNA E MAMUSHËS

- **Raportoj aktivitetin gjashtë-mujor:** Kryetari i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe raportin gjatë-mujor të punës komunale, raportet për konsultime me publikun dhe dëgjimet buxhetorë, planet zhvillimore të komunës; po ashtu, Zyra për Informim duhet të publikojnë ditën se kur kryetari pret qytetarët përvizita, dhe të gjitha të dhënat biografike të Kryetarit dhe Drejtoreve.
- **Transparencë e shpenzimeve komunale:** Komuna në rast të kërkesës duhet të dërgojë raportet tre-mujore të shpenzimeve, raportet për ndërmarrje komunale, rajonale dhe si dhe listat e pronave në pronësi të komunës si dhc ato të marra me qira për Komunën;

QEVERISJA LOKALE DHE PJSËMARRJA QYTETARE

(D)

- **Linjë telefonike direkte gratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte për brengat e qytetarëve, dhe të mbajë takime me organizata të shoqërive civile.
- **Raportim para Përfaqësuesve Lokal:** Kryetari duhet të bëje raportimin për gjendjen socio-ekonomike të komunës çdo gjashtë muaj para në Kuvend Komunal ashtu siç parashihet edhe me ligj.
- **Materiali përcjellës në dëgjime publike:** Komuna duhet që gjatë dëgjimeve buxhetore të shpërndajë materiale përcjellëse, të publikojë draft-buxhetin e komunës për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, dhe të përpilojë një rregull për pjesëmarrjen e qytetarëve.
- **Transparencë në prokurim:** Komuna duhet ta bëjë publike në ueb-faqe borxhin publik komunal, raportin e auditimit, planin e prokurimit dhe njoftimet për kontratë dhe për dhënien e kontratave.
- **Kuvendi i Komunës më i qasshëm në ueb:** Kuvendi i Komunës duhet të publikojë rendin e ditës së seancave në ueb-faqe në kolonën adekuatë në mënyrë që të gjindet më lehtë, të publikojë draft-rregulloret e Kuvendit Komunal, të gjitha detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit si dhe email adresat e tyre.

(D)

ANEKSET, INDIKATORËT DHE KOMENTET

ANEKS 1: INDIKATORËT DHE PESHA E TYRE

#	KUVENDI I KOMUNES	PESHA	#	FINANCAT	PESHA
1	Mbajtja e seancës mëjore	5	1	Raportet e shpenzimeve tre-mëjore	5
2	Qasja në rregulloret & vendimet	5	2	Publikimi i kontratave	5
3	Qasja në Procesverbale	4	3	Plani, buxheti dhe projektet kapitale	4
4	Detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit	4	4	Të hyrat veta nake	4
5	Plani për transparencë në komunë	3	5	Ndryshimet në buxhet nga legjislativi	3
6	Seancat e hapura për publik	3	6	Borxhi publik komunal	2
7	Qasja në draftet e rregulloret e planeve	3	7	Plani i prokurimit	3
8	Qasja në dokumente të Komiteteve	3	8	Njoftimet për kontrata	3
9	Qasja në Rend të Ditës	2	9	Buxhetet e ndërmarrjeve komunale	2
10	Komitetele e hapura për publik	2	10	Lista e pronave komunale	3
11	Organizimi i Kuvendit dhe përgjegjësitet	1	11	Raporti i auditimit	1
PIKË GJITHSEJ		35	PIKË GJITHSEJ		35

#	ZYRA E KRYETAR/IT/ES	PESHA	#	KONSULTIMET PUBLIKE	PESHA
1	Raporti Gjashtëë-Major i Punës	5	1	Linjë direkte pa pagesë për qytetarët	3
2	Niveli i përgjigjes së kërkesave zyrtare	4	2	Rifreskimi i faqes së Facebook	4
3	Raportimi i Kryetar/it/es në Kuvend	4	3	Takimet publike të rregullta	5
4	Planet Zhvillimore të Komunës (PZHU)	4	4	Dëgjimet publike për Buxhet (prope./banorë)	5
5	Zyrtarë për informim & Koordinatori	3	5	Draft-Buxheti i Komunës në konsultime	3
6	Raport për konsultimet me publikun	2	6	Njoftimi (on&offline) për dëgjimet publike	3
7	Konkurs për punësim dhe kriteret ne web faqe	5	7	Materiali përejellës për konsultimet	3
8	Detajet biografike – Kryetarit & Drejtoreve	3	8	Rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve	3
9	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare	2	9	Takimet me organizata të shoqerisë civile	3
10	Lajme të subjekteve politike opozitare	2	10	Konsolidimi & konsultimi i bashkësive lokale	2
11	Vizitat javore	1	11	OJQ në Këshillin e Sigurisë në Bashkësi	1
PIKË GJITHSEJ		35	PIKË GJITHSEJ		35

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

ANEKS 2: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (1)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KUVEND KOMUNAL	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Ueb-Faqe	Qasja në irregulloret, vendimet dhe planet	1	2	3	3	2	2
Fizikisht	Mbajtja e Seancave të rregullta (10 në vit)	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Qasja në Procesverbale	0	3	2	2	0	0
Ueb-Faqe	Detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit	1	0	2	0	0	0
Fizikisht	Plani për transparencë në komunë	3	0	0	0	0	0
Fizikisht	Seancat e hapura për publik	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Qasja në draftet e rregulloreve dhe planeve	1	0	1	0	0	0
Fizikisht	Qasja në dokumente në shqyrtim te Komiteteve	1	1	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Qasja në Rendin e Ditës	1	2	1	2	1	0
Fizikisht	Komititet e hapura për publik	3	3	2	3	2	2
Ueb-Faqe	Organizimi i Kuvendit dhe përgjegjësit	1	1	1	1	1	1

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KZEKUTIVIN E KOMUNËS	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MANUSHË
Ueb-Faqe	Raporti Gjashtë-Mujori Punës	2	0	0	0	0	0
KërkesëZyrt.	Niveli i përgjigjes për qasje në dokumente publike	1	2	1	1	1	1
Fizikisht	Raportimi i Kryetarit/es në Kuvend	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Planet Zhvillimore të Komunës (PZHU)	3	2	2	1	2	0
Fizikisht	Zyrtarë për informim& Koordinatori për qasje në dokumente publike	2	3	1	3	0	0
KërkesëZyrt. Ucb-faqe	Raport për konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore	0	0	1	0	0	0
Ueb-Faqe	Konkurs për punësim dhe kriteret ne web faqe	3	3	3	3	0	0
Ueb-Faqe	Detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtoreve	3	3	3	3	2	2
Ueb-Faqe	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhë në përdorim)	2	1	1	0	1	1
Ueb-Faqe	Lajme të subjekteve politike opozitare në Kuvend	0	0	0	0	0	0
Fizikisht	Vizitat javore Kryetarit	0	1	0	1	0	0

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

ANEKS 3: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (?)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA FINANCIARE	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Ueb-Faqe	Raportet tre-mujore të shpenzimeve (detajuara)	0	0	3	3	0	1
KërkesëZyrt.	Publikimi i kontratave	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Plani, buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale	0	0	2	1	0	1
Ueb-Faqe	Të hyrat vetanake të komunës	0	0	0	0	0	0
KërkesëZyrt.	Ndryshimet buxhetore të miratuar nga Kuvendi	0	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Borxhi publik komunal	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Plani i prokurimi	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Njoftimet për kontratë dhe për dhëni e kontratave	2	2	2	0	0	0
KërkesëZyrt.	Buxhetet dhe shpenzimet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale	0	0	2	0	0	0
KërkesëZyrt.	Lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) në pronësi komunale dhe të hyrat e detajuara	3	0	3	0	0	0
Ueb-Faqe	Raporti i auditimit	0	0	0	0	0	0

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Fizikisht	Linjë direkte pa pagesë për brengat e qytetarëve	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Rifreskimi i faqes së Facebookut	2	3	0	3	0	0
Fizikisht	Takimet publike të rregullta	2	0	0	3	0	0
Fizikisht/Ueb	Dëgjimet publike për buxhet (proce./banorë)	0	0	0	1	1	2
Ueb-Faqe	Draft-Buxheti i Komunës (ose draft rishikimit)	0	0	0	0	0	0
Fizikisht/Ueb	Njoftimi (on dhe offline) për takimet publike	3	3	2	3	1	1
Fizikisht	Materiali përcjellës në dëgjime buxhetore	0	0	0	0	0	0
Fizikisht	Rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve	0	0	0	0	0	0
Fizikisht	Takimet me organizatat e shoqërisë civile	1	1	1	1	0	0
Fizikisht	Konsolidimi dhe konsultimi i bashkësive lokale	0	1	1	2	1	0
Fizikisht	OJQ në Këshillin Komunal për Siguri	3	1	1	1	3	1

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

352 (496.51-21)”2015”(047.3)

Transparometri komunal : Prizren, Suharekë, Rahovec,
Malishevë, Dragash : janar-qershori 2015 / Institut
Demokratik i Kosovës. – [Prishtinë] : Institut Demokratik i
Kosovës, 2015.- 35 f. : ilustr ; 28 cm.

ISBN 978-9951-8901-7-5

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënieve nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rrëth KDI ju lutem viziton www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



This publication is part of the project **Civic Involvement for Transparency and Accountability**, implemented by **Kosova Democratic Institute**, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

ISBN 978-9951-8901-7-5

9 789951 890175

